

1 E premte, 5 nëntor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

4 --- Fillon në orën 09.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes të gjithëve. Znj. Sekretare, ju lutem, thërrisni
7 çështjen.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të
9 nderuar. Kjo është çështja KSC-BC-2020-07 e Prokurorit të
10 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 E shoh që z. Halling është me ne prapë sot këtu, ndërkohë
14 që nuk shikoj ndryshim tjetër nga përbërja e Prokurorisë.

15 Z. Rees.

16 Z. REES: [Përkthim] Jemi të njëjtët person që kemi qenë
17 edhe dje, por përveç ekipit, kemi edhe Vladimir Dashin sot në
18 mëngjes.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kemi ndryshime sot.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Për procesverbal, z. Haradinaj dhe z. Gucati janë të dy
24 të pranishëm në sallën e gjyqit.

25 Trupi Gjykses ka një urdhër gojor për të dhënë sa i takon

1 pranimi të provave materiale të dhëna përmes dëshmitares
2 4841, znj. Pumper. Arsyet me shkrim do të jepen javën që vjen.
3 Trupi Gjykses ka dëgjuar dëshminë e dëshmitares 4841 në
4 periudhën nga 18 deri në 26 tetor 2021. Gjatë kësaj kohe, u
5 shty vendimi për pranimin si edhe një numër i provave
6 materiale.

7 Me 28 tetor 2021, Trupi Gjykses dëgjoi parashtrimet
8 gojore nga palët sa i takon pranueshmërisë së këtyre provave
9 materiale. Pasi ka shqyrtuar provat materiale dhe ka shqyrtuar
10 me kujdes parashtrimet e palëve, Trupi Gjykses vendos si më
11 poshtë.

12 Ndërkohë, pranueshmëria e përgjithshme e Mbrojtjes
13 kundërshtohet.

14 Të gjitha provat materiale në Kategoritë 1, 2, 3, 4, 5
15 dhe 6 pranohen në prova materiale.

16 Trupi Gjykses mendon që dokumentet nën Kategorinë 7 nuk
17 janë në aspektin gjyqësor të njoftueshme, por pranon që ato do
18 të pranohen si prova në provat individuale.

19 Trupi Gjykses gjithashtu pranon në prova, provat
20 materiale individuale të të gjitha dokumenteve të cilat jepen
21 nën Kategorinë 8, përveç dokumentit me ERN 07891-078982.

22 Sa i takon dokumenteve që janë shënjuar me numrin e
23 identifikimit P104 nën Kategorinë 2, Trupi Gjykses merr këtë
24 vendim.

25 Në kuadrin e redaktimeve të plota të gjashtë faqeve që

1 përmban informacionin përkatës, Trupi Gjykses nuk është në
2 pozicion që të bëjë gjetje lidhur me autenticitetin,
3 besueshmërinë dhe vlerës provuese të materialit në fjalë.

4 Trupi Gjykses, në fakt, e shtyn vendimin për këtë
5 element.

6 E sa i takon pjesës së panxjerrë të Grupit 2, Paneli e
7 fton ZPS-në që të prodhojë një version më pak të redaktuar ose
8 të paredaktuar të P104, duke redaktuar vetëm atë informacion
9 që është absolutisht i nevojshëm në rrethanat aktuale dhe ta
10 dorëzojë materialin për pranim.

11 Trupi Gjykses vëren se në qoftë se ZPS-ja kërkon pranimin
12 e këtij dokumenti, dokumenti duhet që të jetë i aftë në të
13 gjitha aspektet materiale që të dëshmojë autenticitetin,
14 besueshmërinë dhe vlerën provuese. Në qoftë se ZPS-ja vendos
15 që të bëjë këtë gjë, ajo ftohet që të dërgojë një version më
16 pak të redaktuar ose të paredaktuar sot, me datë 5 nëntor
17 2021.

18 Në qoftë se kjo ndodh, Mbrojtja urdhërohet që të tregojë
19 deri më 8 nëntor 2021, në parashtrime me gojë gjatë seancës,
20 në qoftë se dëshiron që të marrë përsëri në pyetje dëshmitarin
21 04841 në kuadrin e nxjerrjes së materialeve nga ZPS-ja.

22 Udhëzimet e detajuara nga Zyra e Administrimit lidhur me
23 dokumentet specifike dhe vendimet për klasifikimin e tyre do
24 të përfshihen në vendimin e shkruar dhe do të dorëzohen javën
25 që shkon [sipas përkthimit]. Ky është përfundimi i vendimit me

1 gojë.

2 Tani do të kalojmë te diskutimi i hapave pasardhëse në
3 procedurat aktuale. Për përfitim të publikut, dua të them që
4 ne jemi drejt fundit të çështjes së ZPS-së. Kemi vetëm një
5 dëshmitar që ka mbetur. Ne do fillojmë sot ta marrim në pyetje
6 atë dhe do përfundojmë me të ose sot ose të hënën. Më pas do
7 të bëjmë marrjen në pyetje nga Mbrojtja dhe palët e tjera
8 ndoshta të martën, në varësi të nxjerrjes së materialeve nga
9 Prokuroria sot sa i takon P104-ës dhe dokumenteve të tjera
10 pezull nën Rregullin 102(3).

11 Ne kemi gjithashtu edhe çështje të tjera shtesë pezull
12 nën Rregullin 102(3) të cilat do t'i trajtojmë javën e 15
13 nëntorit.

14 Në këtë pikë, do të doja të dija në qoftë se dëshmitarët
15 4841 dhe 4842 mund të jenë të disponueshëm të hënën ose mbase
16 javën e datës 15 nëntor për pyetje të tjera nga Mbrojtja për
17 arsyet të cilat u shpjeguan më sipër.

18 Fjala për ju, z. Prokuror.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do pyes për këtë
20 dhe në qoftë se nuk e keni problem, do t'ju informojmë më pas
21 lidhur me këtë çështje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Në çdo rast prezantimi i çështjes së ZPS-së do të
25 përfundojë në javën që vjen, që është në përputhje me

1 objektivin e 9 nëntorit që kemi përcaktuar më përpara. Trupi
2 Gjykues i është mirënjohës palëve për mbajtjen e ritmit të
3 këtyre procedurave. E dimë që nuk ka qenë gjithmonë e
4 thjeshtë, por kemi bërë progres të konsiderueshëm deri tani.

5 Tani, në përputhje me Rregullin 103, Mbrojtja duhet të
6 njoftojë Trupin Gjykues kur ata synojnë të dorëzojnë mocionin
7 për të hequr dorë. Ne e dimë gjithashtu që kemi edhe pyetje të
8 tjera të cilat janë ende pezull, por Trupi Gjykues do të
9 mirëpriste nga Mbrojtja të hënën që të thoshte se kur pret që
10 të dorëzojë një mocion të tillë. Trupi Gjykues gjithashtu
11 dëshiron që të dëgjojë nga Mbrojtja në qoftë se planifikon që
12 të ketë një çështje të Mbrojtjes.

13 Ne e dimë që sipas Rregullës 119 një njoftim i tillë nuk
14 kërkohet përpara vendimit të mocionit për të rrëzuar akuzat,
15 kështu që do ta vlerësojmë shumë në qoftë se mund të jepni një
16 kontribut të tillë në mënyrë që mund të krijojmë dhe mund të
17 përcaktojmë një afat realist deri në javën tjetër dhe kjo
18 është diçka që është përfituese për të gjitha palët,
19 veçanërisht për të akuzuarit.

20 Do të ishte me ndihmë për neve që të kishim një propozim,
21 një vlerësim të përafërt sa i takon dorëzimit të listës së
22 Mbrojtjeve dhe kur ajo do të jetë në -- e gatshme për
23 përgatitjen -- për Konferencën e Përgatitjes për Mbrojtjen.
24 Trupi Gjykues dëshiron që të dijë gjithashtu edhe akuzat
25 materiale, çfarë pritet për këto akuza materiale si dhe listat

1 e propozuara të dëshmitarëve. Sigurisht që e gjithë kjo varet
2 në qoftë se do të dorëzohet një mocion për të rrëzuar akuzën.

3 Tani, z. Rees dhe z. Cadman, d.m.th. kjo është thjesht
4 një përmbledhje e hapave pasuese, por sigurisht që ju jeni --
5 mirëpriteni që të komentoni, në qoftë se keni komente në këtë
6 moment.

7 Nuk e di, z. Rees në qoftë se ke gjë për të thënë.

8 Z. REES: [Përkthim] Ne planifikojmë një mocion për [e
9 padëgjueshme] dhe nga ana tjetër planifikojmë që në qoftë se
10 do na duhet që të përgjigjemi, mbase do të ketë një çështje të
11 Mbrojtjes po ashtu. Më lejoni që të reflektojmë për komentet
12 që bëtë sot dhe do të jemi në një pozitë më të mirë për të ju
13 ndihmuar juve javën që vjen duke ju dhënë më shumë
14 informacione.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
16 rregull.

17 Z. REES: [Përkthim] Dhe ne do të japim komentet tona siç
18 e shikojmë të përshtatshme në këto rrethana, në mënyrë të
19 tillë që të përcaktohet një kalendar i qartë.

20 Nuk e di në qoftë se mund të trajtoj shkurtimisht
21 çështjen e mundur të rithërritjes këtu të dëshmitarit 0844
22 [siç e tha përkthyesja] dhe të dëshmitarit 0842 [sipas
23 përkthimit]. Ne jemi të vetëdijsëm që urdhri më përpara ka
24 qenë që deri të hënën të mund të japim informacion në qoftë se
25 ne kërkojmë që të rithërriten sërish këto dy dëshmitarë

1 në seancën e gjyqit.

2 Ka një urdhër pezull për nxjerrjen e materialeve që duhet
3 të bëhet nga ana e Prokurorisë. Duhet që të realizohet sot, të
4 respektohet sot kjo çështje dhe siç e kuptojmë nuk do të mund
5 të zgjidhet kjo çështje deri në 12 nëntor.

6 Duam të bëjmë thirrje që vendimi, sa i takon rithirrjes
7 së dëshmitarëve, të presë deri sa të përfundojnë nxjerrjet e
8 të gjitha dokumenteve që janë pezull sepse nuk na duket ne që
9 po përdorim në mënyrë të dobishme kohën e Gjykatës për
10 rithirrjen e këtyre dëshmitarëve që të bëhet në mënyrë të
11 fragmentuar. Në qoftë se do vendoset që do të rithërriten këto
12 dëshmitarë, ne do ta kërkojmë këtë gjë, por do të jetë mirë që
13 të kemi marrë të gjitha informacionet që duhen të nxirren nga
14 Prokuroria përpara sesa të merret ky vendim dhe pastaj marrja
15 në pyetje në një seancë të dytë të këtyre dëshmitarëve të mund
16 të realizohet pasi janë shqyrtuar të gjitha dokumentet.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta
18 shqyrtojmë këtë gjë dhe do të marr një vendim më vonë, gjatë
19 ditës së sotme, lidhur me kërkesën tuaj.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Sa i takon çështjes së nxjerrjes së
21 dokumenteve, jam plotësisht dakord me atë çfarë tha z. Rees.
22 Kështu që, do të presim gjithashtu edhe mendimin tuaj deri në
23 fund të ditës për këtë pikë.

24 Sa i takon kërkesës për të hequr dorë, pozicioni ynë
25 është që çështja e Prokurorisë, e prezantuar para nesh deri

1 tani, na çon ne në parashikimin që do të bëjmë një kërkesë.
2 Sigurisht, do t'ju japim një listë të detajuar të provave që
3 neve synojmë që të përdorim dhe siç tha dhe z. Rees, ne jemi
4 pragmatikë edhe do të duhet që të shqyrtojmë në qoftë se do të
5 duhet që të thërriten apo jo edhe një herë dëshmitarët e
6 përmendur më sipër.

7 Ndërkohë, një tjetër çështje që do të doja të sillja në
8 vëmendjen tuaj është ndoshta mundësia e një eksperti shtesë në
9 mënyrë që të keni mundësi që të komunikojmë. Eksperti në fjalë
10 ka thënë që ka përfunduar pjesën kryesore të raportit,
11 ndërkohë që ne nuk është se e kemi parë draftin e raportit,
12 por na është thënë që e ka përfunduar, le të themi, draftin e
13 parë, por ai ka nevojë që të konsultohet me transkriptet e
14 disponueshme publike të znj. Pumper, në mënyrë që të japë
15 dorën e fundit raportit, kështu që ka kërkuar që deri të hënën
16 t'i jepet e drejta, pra t'i jepet afat që të dorëzojë
17 raportin, kështu që unë nga ana tjetër e kam thekuar rëndësinë
18 shumë të madhe të çështjeve -- të përshpejtimit të çështjeve
19 sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, një pjesë e vonesës
20 është shkaktuar edhe si rezultat i komunikimit me ZPS-në. Nuk
21 është se po kritikoj këtu, po thjesht po them të vërtetën dhe
22 çështja tjetër është vonesa në marrjen e transkripteve
23 publikisht të disponueshme. Deri tani ne kemi vetëm dy nga
24 këto transkripte, d.m.th. provat e znj. Pumper. Sigurisht që
25 do të marrim edhe transkriptin e ditës së djeshme dhe

1 transkriptet që do të prodhohen sot dhe mbi bazën e të gjitha
2 atyre transkripteve do të përfundohet raporti të hënën, kështu
3 që do ju kërkonim që të na e miratonit shtyrjen për dorëzimin
4 e raportit deri të hënën.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta
6 shqyrtojmë këtë së bashku me vendimin që përmenda pak më
7 përpara.

8 [Anëtarët e trupit gjykues këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
10 i çaktivizuar].

11 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.
12 Shkurtimisht sepse u përmend afati për nxjerrjen e materialit
13 që është sot. Thjesht dua që të informoj Gjykatën që ne jemi
14 në dijeni të këtij afati. Në qoftë se do kërkojmë leje për
15 apel, atëherë do ta kërkojmë këtë gjë sot edhe siç thashë,
16 d.m.th. pak më vonë do të kem më shumë informacion lidhur me
17 këtë çështje, përderisa vendimi është marrë kohët e fundit.
18 Por ky është thjesht një informacion i përgjithshëm sepse
19 mbase kjo mund të ketë ndikim mbi procedurat e ardhshme.
20 Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

22 Faleminderit, z. Pace.

23 Një pyetje tjetër është në qoftë se të akuzuarit kërkojnë
24 që të bëjnë një deklaratë në fund të çështjes së ZPS-së. Siç
25 ka thënë Trupi Gjykues, ne do t'i japim mundësinë të akuzuarve

1 që të bëjnë deklaratë jo në deklaram në kohët specifike. Në
2 qoftë se do të vendoset për të dhënë deklaratë të tilla para
3 Gjykatës, e hëna mund të jetë një kohë e përshtatshme për këtë
4 gjë.

5 Nuk e di në qoftë se keni ndonjë koment lidhur me këtë,
6 z. Rees.

7 Z. REES: [Përkthim] Jemi mirënjohës. Ne parashikojmë që
8 z. Gucati dëshiron që të bëjë një deklaratë përpara Gjykatës
9 dhe fundi i çështjes së Prokurorisë do të ishte një moment i
10 përshtatshëm për ne.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z:
12 [Përkthim] Cadman.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Sigurisht që do konfirmoj deri në
14 fund të ditës, por ka shumë të ngjarë që pozicioni ynë të jetë
15 i ngjashëm me atë të z. Gucati.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
17 rregull. Po ashtu të hënën iu kërkoj palëve që të sjellin në
18 vëmendjen tonë çështje të tjera që duan që të zgjedhim përpara
19 sesa të vijojmë me fazën tjetër të procedurave.
20 Për temën tjetër, do të futemi në seancë private sepse është
21 një çështje që ka të bëjë me personat e mbrojtur -- me një
22 person të mbrojtur.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 jemi në seancë publike.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

9 Faleminderit, znj. Sekretare.

10 Për publikun, gjatë seancës publike do të doja të thoja
11 që ne kemi dhënë argumentet lidhur me dhënien e statusit të
12 dëshmitarit të mbrojtur të dëshmitarit të ZPS-së 4873 [sipas
13 përkthimit]. Trupi Gjykses kujton që ka mohuar kërkesa të
14 tilla të mëparshme nga ZPS-ja dhe nga dëshmitarët e mbrojtur
15 sepse pretendimet e dëshmitarit në rastin konkret ishin që ai
16 mund të ishte në rrezik, qoftë ai apo anëtarë të tjerë të ZPS-
17 së.

18 Kërkesa aktuale nuk është e ndryshme nga kërkesat e
19 mëparshme që i janë drejtuar Trupit Gjykses. Risqet e
20 përmendura janë thjesht hipotetike dhe teorike.

21 Trupi Gjykses gjithashtu kujton gjetjet e tij në Vendimin
22 për Masat Mbrojtëse, që është dokumenti F303. ZPS-ja, stafi i
23 ZPS-së, bie nën kategorinë e dëshmitarëve apo personave të
24 cilët janë në të njëjtin pozicion si policia dhe autoritet e
25 tjera hetimore dhe është pjesë e natyrës së tyre që të japin

1 dëshmi para Trupit Gjykues.

2 Për pasojë, kjo kërkesë rrëzohet.

3 Z. Rees, z. Cadman, a mund të na thoni se sa parashikoni
4 që të zgjasë marrja në pyetje prej jush e dëshmitarit 4876?

5 Z. Rees, fjala për ju.

6 Z. REES: [Përkthim] Deri në një orë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shumë do të
9 varet nga ajo çfarë do të thotë dëshmitari. Por, unë do të
10 mbështetem me atë çka do të thotë z. Rees. Në qoftë se do të
11 kem pyetje të tjera, nuk pres që këto pyetje të më kërkojnë
12 shumë kohë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 Në mënyrë që të njoftojmë vendimin që sapo morëm për
16 dëshmitarin e radhës, do të bëjmë një pushim prej 15 minutash.
17 Mund të që qëndroni aty ku jeni, nëse doni, mund të pushoni.
18 Ne do të dalim nga salla, por gjithsesi, siç e thashë do të
19 bëjmë një pushim tani për 15 minuta, pastaj do të kthehemi
20 sërish. Qëllimi është kjo që unë thashë më përpara.

21 Z. REES: [Përkthim] E keni problem në qoftë se ne dalim
22 nga salla?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jo, fare.

24 D.m.th., thjesht për të ju informuar se seanca do fillojë për
25 15 minuta.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

2 --- Pauza fillon në orën 09.56

3 --- Seanca rifillon në orën 10.15

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Përpara se
5 të sjellim dëshmitarin për të dëshmuar, u kujtojmë palëve se
6 fushëveprimi i dëshmisë së 4867, sikurse përcaktuar në
7 dokumentin F408, është që ai mund të dëshmojë nga ato që mban
8 mend nga ato ngjarjet që trajtohen në P92, P103, P105, MFI dhe
9 në notën zyrtare 102754 dhe 102755.

10 Përveç vendimit të kohëve të fundit bazuar për çështjet e
11 Rregullës 102(3), Trupi Gjykues lejoi që mbrojtja e Gucatit të
12 pyesë dëshmitarin për disa nga akuzat për nxitje për vepër
13 penale.

14 Kini parasysh këto parametra kur merrni në pyetje
15 dëshmitarin. Tani duam të thërresim dëshmitar.

16 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
18 Mirëmëngjes, z. Moberg.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] [Mikrofoni i çaktivizuar].

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretarja
21 do të të japë deklaratën zyrtare të cilën duhet ta bësh sipas
22 Rregullës -- Rregullores dhe Rregullit 141 (2).

23 Kur të jesh gati, vazhdo.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
25 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj

1 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
2 vetëm të vërtetën edhe nuk do të të mbaj të fshehtë asgjë për
3 të cilën kam dijeni.

4 DËSHMITARI: DANIEL MOBERG

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

6 Faleminderit, z. Moberg. Mund të uleni.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Moberg,
8 sot do të fillojmë dëshminë tuaj. Siç mund ta dini, Prokuroria
9 do t'ju bëjë pyetje e para dhe pasi të mbarojë Prokuroria, të
10 drejtën e ka Mbrojtja për të bërë pyetje, por edhe pjesëtarët
11 e Trupit Gjykes mund të ju bëjnë disa pyetje.

12 Prokuroria parashikon që t'ju pyesë për një kohë prej dy
13 orësh, Mbrojtja rreth një orësh. Nuk janë premtime, janë vetëm
14 vlerësime të përafërta, të cilat shpresojmë t'u përmbahemi.

15 Përgjigjuni pyetjeve me përgjigje të shkurtra. Në qoftë
16 se nuk i kuptoni pyetjen, kërkoheni Prokurorit t'jau sqarojë
17 që ta kuptoni dhe ta sqaroheni. Pastaj, përpiquni të vini në
18 dukje bazën ku i mbështetni njohuritë dhe rrethanat për të
19 cilat mund të pyeteni.

20 Trupi Gjykes e kupton se ZPS-ja mund t'ju pyesë për të
21 vërtetuar disa ndryshime që keni bërë në deklaratat tuaja. Në
22 qoftë se ndodh kjo gjë, duhet që të thoni ato -- lista e
23 ndryshimeve pasqyron deklaratën tuaj, nëse e pasqyron.

24 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda para se
25 të përgjigjeni. Flisni me ngadalë me qëllim që përkthyesi të

1 të përgjigjeni. Flisni me ngadalë me qëllim që përkthyesi të
2 mund t'ju ndjekin.

3 Gjatë kohës së dhënies së dëshmisë, nuk lejoheni të
4 diskutoni me askënd përmbajtjen e deklaratës tuaj. Në qoftë se
5 dikush ju pyet jashtë kësaj salle të gjyqit për dëshminë tuaj,
6 ju lutem na vini në dijeni.

7 Z. Prokuror, mund të filloni.

8 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

9 Pyetje nga z. Pace:

10 Z. PACE: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. dëshmitar.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes.

12 Py. Ne njihemi, por do t'ju bëj disa pyetje që të vërtetojmë
13 historikun tuaj dhe emrin.

14 Si quheni?

15 Pë. Daniel Moberg. Në pasaportë do të shikoni më shumë emra
16 sepse ne, si suedezë, kemi shumë, Lars Johan Daniel, por
17 Danieli është ai që përdoret.

18 Py. Ku punoni aktualisht?

19 Pë. Në Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

20 Py. Çfarë pune bëni, çfarë posti keni?

21 Pë. Punonjës operativ i sigurisë.

22 Py. Këtë post keni pasur dhe në 2020-ën?

23 Pë. Po.

24 Py. Mbani mend që keni shkuar në zyrat e OVL UÇK-së në
25 Prishtinë në datën 8 shtator 2020?

1 Pë. Po.

2 Py. A mund t'i thoni Gjykatës se përse shkua aty ditë?

3 Pë. Shkova me një urdhër gjykate për të sekuestruar dokumente
4 të cilat ishin dorëzuar në zyrën e OVL UÇK-së.

5 Py. Kur shkua aty, çfarë bëtë me këtë urdhrin e gjykatës?

6 Pë. Po. Një kopje e këtij urdhri iu dha sekretarit të
7 shoqatës OVL UÇK-së, si përfaqësues i saj.

8 Py. Ju thatë që shkua aty për të sekuestruar disa dokumente,
9 në 8 shtator. I sekuestruat?

10 Pë. Po.

11 Py. A ju kujtohet se ç'bëtë me ato dokumente që sekuestruat
12 atë ditë?

13 Pë. Pasi i sekuestruam, i çuam në zyrat tona në Prishtinë, ku
14 kolegët filluan t'i skanonin që t'i dërgonin në zyrë në mënyrë
15 digjitale.

16 Py. Vazhdoni, në qoftë se keni ndonjë informacion tjetër me
17 rëndësi.

18 Pë. Më pas, ato u futën në një kasafortë. Origjinalët u
19 sollën këtu në Hagë, rreth afërsisht dhjetë ditë më vonë.

20 Py. Nga e dini ju se ku janë ruajtur e si janë transportuar?

21 Pë. Unë i futa në kasafortën e zyrave tonë dhe unë ia
22 dorëzova Prokurorit që i solli në Hagë.

23 Py. Kur i futët në kasafortë dokumentet, i futët në të
24 njëjtën mënyrë se si i kishit marrë?

25 Pë. I futëm në dy qese provash.

1 Py. E dini kush i futi në këto dy qese?

2 Pë. Besoj që e bëra unë vetë këtë.

3 Py. Këto qese të provave kishin vetëm ato dokumente që
4 sekuestruat aty në zyrat e OVL UÇK-së apo edhe të tjera?

5 Pë. Ishin edhe dokumentet e dorëzimit që i nënshkroi
6 sekretari dhe unë vetë në kohën e sekuestrimit.

7 Py. Këto qese ishin të vulosura kur i futët në kasafortë?

8 Pë. Nuk mund të them me siguri që ishin të vulosura në atë
9 moment, por e di që u vulosën në kohën që u dërguan në Hagë.

10 Py. E dini se kush i ka vulosur?

11 Pë. Me shumë gjasë e kam bërë unë vetë.

12 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua t'i tregoj dëshmitarit një
13 dokument që është P92 MFI, ERN 083988 deri në 083991RED.

14 Py. Z. dëshmitar, e shikoni që keni një dokument përpara në
15 ekran?

16 Pë. Po.

17 Py. E njihni këtë dokument?

18 Pë. Po.

19 Py. A mund të na thoni në përgjithësi se për çfarë bën fjalë
20 ky dokument?

21 Pë. Dokumenti detajon ngjarjet që ndodhën në kohën e
22 sekuestrimit dhe si dokumentet u sekuestruan.

23 Py. Dhe -- për të qenë të qartë, po kur thoni "sekuestrim", e
24 keni fjalën për sekuestrimin e dokumenteve që ju tregova për
25 të cilën folëm në 8 shtator?

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 23

1 Pë. Po.

2 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 083990 të të
3 njëjtit dokument.

4 Py. Z. dëshmitar, a e njihni nënshkrimin tuaj?

5 Pë. Po.

6 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, të kalojmë, ju lutem,
7 te faqja e parë. Faleminderit.

8 Py. Z. dëshmitar, në këtë faqe, në fillim, shohim emblemën e
9 ZPS-së dhe pastaj "Notë Zyrtare" dhe pastaj ka një tabelë ku
10 ka informacion që përshkruan datën, autorin dhe subjektin apo
11 temën dhe pastaj fillon teksti poshtë, nën subjektin. A mund
12 të na thoni nëse është një standard i zakonshëm -- një format
13 standard?

14 Pë. Me sa di unë është formati standard.

15 Py. Kur shohim tekstin, në faqen e parë dhe në faqet e tjera,
16 shohim që përmend -- flitet për ngjarje që kanë ndodhur, duke
17 filluar nga paragrafi 1 dhe më pas, në datën 8 shtator 2020.

18 Z. PACE: [Përkthim] Pastaj ta kalojmë te dy faqet 083990.

19 Py. Paragrafi 14, shohim se përmendet një ngjarje e ndodhur
20 në 17 shtator 2020; dhe në paragrafin 15 bëhet fjalë për një
21 ngjarje e ndodhur në 21 tetor 2020. Më ndiqni?

22 Pë. Po.

23 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë përsëri te faqja e parë,
24 083998 [sipas përkthimit].

25 Py. Në këtë tabelë, tek data, shohim 21 tetor 2020.

1 A mund të na shpjegoni përse bën fjalë kjo datë, duke
2 pasur parasysh dhe ngjarjet që përmende në tekstin e notës?
3 Pë. Është data kur e futëm tekstin në këtë format dhe në
4 dhënien e DVD-së si një diçka -- një material i bashkëngjitur
5 që ishte një pjesë e shkurtër filmike e bërë nga unë me
6 telefonin celular, në kohën e sekuestrimit, nga kamera e
7 sigurisë në zyrat e UÇK-së. Nuk e mbaj mend kush na -- kujt ia
8 dhamë dokumentin.

9 Py. Kur thoni -- nuk e kuptoj pse ia keni dhënë diku këtë --
10 dikujt këtë dokument?

11 Pë. Shkurt që të futet në ZyLAB.

12 Py. A mund të na thoni përse -- ç'është ZyLAB-i?

13 Pë. Është programi që ka dokumentet e mbledhura nga ZPS-ja.

14 Py. A ju kujtohet që këtë javë ju është dhënë mundësia që të
15 bëni sqarime lidhur me këtë "Notë Zyrtare"?

16 Pë. Po.

17 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, Sekretare, të vendosni
18 përbri këtij dokumenti dokumentin 103915 deri në 103915. Nuk
19 ka një numër MFI.

20 Py. Z. dëshmitar, e njihni dokumentin në anën e majtë të
21 ekranit?

22 Pë. Po.

23 Py. Shikoni tekstin, nën numrin ENR, aty ka dy pika. Pra,
24 numrin ERN 083988. Mund të na thoni nëse janë sqarime apo
25 korrigjime që keni bërë për notën e datës 21 tetor?

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 25

1 Pë. Po.

2 Py. Duke pasur parasysh sqarimet në krahun e majtë,
3 informacionin që keni dhënë në dokumentin që mban datën 21
4 tetor, është i saktë dhe i vërtetë me sa ju dini dhe besoni?

5 Pë. Po.

6 Py. Informacioni në dokument që mban datën 21 tetor që
7 përfshin këto sqarimet në anën e majtë të ekranit a pasqyron
8 me saktësi ato që do të thoshit po të pyeteshit për ngjarjet
9 të cilat regjistrohen aty?

10 Pë. Po.

11 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e dokumentit i cili
12 ka shenjën MFI P92, bashkë me përkthimin në shqip dhe notën në
13 anën e majtë që është dokumenti 103915 deri ke 103915 që
14 përmban sqarime.

15 Për sa i takon klasifikimit të notës të 21 tetorit,
16 përpara sesa të bëhet e disponueshme publikisht, kërkojmë që të
17 heqim emrin e punonjësit të dytë të sigurisë operative që
18 përmendet aty, por jo të dëshmitarit, duke pas parasysh
19 vendimin tuaj të sotëm, po dhe emrin e vëzhguesit të pavarur.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
21 kundërshtim Mbrojtja?

22 Z. REES: [Përkthim] Jo, i nderuar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] z. Cadman?

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] P92 MFI do

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 26

1 të pranohet si dokumenti P92 plus përkthimi në shqip.

2 Dokumentit 103915, që përfaqëson korrigjimet e Notës Zyrtare,
3 duhet t'i caktohet një numër P.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të jetë dokumenti me
5 numrin P138.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ky
7 dokument, P138, pranohet si dëshmi. Klasifikimi do të jetë
8 publik, përveç, siç u vu në dukje, dy emrave në notë, të cilat
9 mund të redaktohen, përpara sesa të bëhet publike.
10 Vazhdoni.

11 Z. PACE: [Përkthim] Sa të jetë e qartë, do ta bëjmë ne si
12 Prokurori redaktimin apo do ta bëjë Zyra e Administratës?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund ta
14 bëni ju dhe ta ofroni për miratim.

15 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.
16 Py. Z. dëshmitar, gjatë sekuestrimit të 8 shtatorit të cilën
17 përmendëm pak më herët, a i keni thënë ndonjëri nga ata të
18 pranishëm në zyrat e OVL UÇK-së se mund t'i mbanit dokumentet
19 që ju do kishit shkuar për t'i sekuestruar deri në 30 ditë?

20 Pë. Jo, nuk u bë një diskutim i tillë.

21 Py. A iu thatë që mund t'i mbanit ato dokumente për një
22 periudhë kohe?

23 Pë. Jo.

24 Py. Me sa keni dijeni, keni thënë ndonjë gjë që të kuptohej
25 se nënkuptonte që mund t'i mbanin këto dokumente?

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 27

1 Pë. Jo.

2 Py. Mbani mend nëse anëtarë të tjerë të stafit të ZPS-së që
3 ishin të pranishëm, kanë folur gjatë sekuestrimit? Ndonjëri
4 prej --

5 Pë. Anëtari i dytë i ZPS-së nuk foli fare gjatë gjithë
6 takimit.

7 Py. Me sa dini ju, i morët të gjithë dokumentet që ju vuri në
8 dispozicion përfaqësuesi i OVL UÇK-së atë ditë?

9 Pë. Po, i mora të gjithë dokumentet që na dhanë.

10 Py. Z. dëshmitar, përveç sekuestrimit të 8 shtatorit, keni
11 shkuar përsëri në OVL UÇK për sekuestrime të tjera mbas asaj
12 date?

13 Pë. Po, dy herë.

14 Py. A i mbani mend datat e dy sekuestrimeve të tjera?

15 Pë. Nuk i mbaj mend përmendësh.

16 Z. PACE: [Përkthim] Nuk besoj se është e kundërshtushme,
17 e diskutushme që unë t'ia them dëshmitarit këto data.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
19 i çaktivizuar].

20 Z. PACE: [Përkthim]

21 Py. Pra, z. dëshmitar, e ka fjalën për sekuestrimin e dytë që
22 ka ndodhur në 17 shtator dhe i treti në 22 shtator.

23 Duke u referuar të dy këtyre, të dytit dhe të tretit ku
24 ju keni marrë pjesë, ju vetë keni folur me ndonjë nga
25 përfaqësuesit e OVL UÇK-së apo anëtarët e tyre?

1 Pë. Nuk flas shqip, thjesht jemi përshëndetur, kështu. Por
2 fola dhe me z. Haradinaj sepse ai flet suedisht dhe e dinte që
3 unë isha suedez. Këto biseda ishin kryesisht për gjëra të
4 përgjithshme, përshëndetje e kështu me radhë.

5 Py. Në përshëndetjet dhe ato bisedat e përgjithshme me z.
6 Haradinaj, a thatë ndonjë gjë lidhur me faktin që OVL UÇK-ja
7 mund t'i mbante dokumentet që ju kishit shkuar për të
8 sekuestruar për një periudhë kohe?

9 Pë. Jo.

10 Py. Me sa ju dini, ndonjë nga të pranishmit që ishin aty nga
11 ZPS-ja bëri ndonjë deklaratë të tillë, në qoftë se e dini?

12 Pë. Nuk e di që të ketë bërë.

13 Py. Dua që të përqendrohemi te sekuestrimi i datës 17 shtator
14 që është hera e dytë që keni shkuar në zyrat e OVL UÇK-së. A
15 mund të na thoni se çfarë detyre apo roli keni pas gjatë këtij
16 sekuestrimi?

17 Pë. Roli im ishte pjesërisht të drejtoja hetimin që ishte me
18 mua, i cili do të bënte sekuestrimin sepse unë e dija ku
19 ndodhej zyra se kisha qenë përpara. Gjithashtu, do të
20 përgjigjesha për sigurinë dhe do të mbaja qesen për
21 sekuestrimin e dokumenteve.

22 Py. A mund të na thoni se çfarë mbani mend nga ngjarjet e
23 asaj dite që nga momenti që ju dhe kolegu juaj hyri në zyrat e
24 OVL UÇK-së dhe bëhet fjalë për 17 shtatorin, për herën e dytë
25 që keni qenë aty?

1 Pë. E kam pak të vështirë t'i ndaj këto dy ngjarje, çfarë
2 ndodhi tek njëra dhe ke e -- ke tjetra.

3 Py. Në këtë rast, z. dëshmitar, le t'i trajtojmë të dy
4 ngjarjet bashkë. Në fillim do t'ju pyes më në përgjithësi si
5 për sekuestrimin e dytë të 17 shtatorit dhe atë të 22
6 shtatorit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
8 i çaktivizuar].

9 Z. REES: [Përkthim] Do të pres të dëgjoj pyetjen, por
10 nuk më duket se është vështirë për dëshmitarin të flasë për të
11 dy ngjarjet.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do t'i
13 japim mundësinë ta bëjë një gjë të tillë.

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 Py. Z. dëshmitar, siç po thosha, ju thatë e keni pak të
16 vështirë të bëni dallimin midis këtyre dy ngjarjeve. Unë do
17 t'ju pyes e mund të përgjigjeni për të dyja, nëse keni mundësi
18 të përgjigjeni për një, bëjeni këtë.

19 A kujtoni që në 17 apo 22 ju keni dorëzuar ndonjë
20 dokument përfaqësuesve të OVL UÇK-së?

21 Pë. Dokumentet e ZPS-së e keni fjalën?

22 Py. Po.

23 Pë. Të dy herët u kemi dorëzuar dokument. Unë nuk u angazhova
24 vetë në bisedime dhe prandaj nuk bëj dot edhe dallimin.

25 Py. A ju kujtohet nëse është sekuestruar ndonjë dokument në

1 njërin apo në të dy rastet, pra në 17 dhe 22?

2 Pë. Në të dy rastet dokumentet u sekuestruan. Në një nga
3 rastet morëm nga zyra e z. Gucatit, një kat më sipër, ishin
4 çuar në një dhomë më të madhe edhe ato ishin vendosur në disa
5 tavolina. Kjo ndodhi në një nga këto ngjarje.

6 Py. A e mbani mend se si dokumentet u nxorën jashtë OVL UÇK-
7 në njërin apo në të dy rastet?

8 Pë. E di që në njërin nga rastet - më duket ishte e para nga
9 të dyja - dokumentet u transportuan nga unë vetë dhe iu
10 dorëzuan përgjegjësit tim diku në Prishtinë për t'i parë
11 shpejt e shpejt.

12 Py. Pa përmendur ndonjë emër konkret, a mund të na thoni kush
13 ishte shefi juaj, çfarë posti kishte?

14 Pë. Po, ishte shefi i njësisë së sigurisë së dëshmitarëve dhe
15 operacioneve.

16 Py. Për të qenë të qartë, ju vetë ia dërguat këto dokumente
17 përgjegjësit tuaj?

18 Pë. Po.

19 Py. Kur ia çuat përgjegjësit, ishin faqe të veçanta apo ishin
20 futur në një zarf apo?

21 Pë. Ishin në prova -- në qeset e provave, po që nuk ishin të
22 vulosura.

23 Py. A ju kujtohet se çfarë ndodhi pasi ia keni dhënë këto
24 dokumente përgjegjësit? Bëri ndonjë gjë ai me to a përse? Apo
25 se nuk e dini?

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 31

1 Pë. U skanuan dhe u dërguan në zyrë dhe u krahasuan me
2 sekuestrimin me dokumentet e sekuestrimit të parë.

3 Py. Ju thatë që dokumentet u skanuan dhe u dërguan në zyrë.

4 Që të kuptoj, dokumentet e skanuara ishin ato që u sekuestruan
5 në atë rast në OVL UÇK?

6 Pë. Po. Ato dokumentet e sekuestruara u skanuan, u koduan dhe
7 u dërguan përsëri në zyrë.

8 Py. Ju përmendët dhe krahasimin e dokumenteve - më duket
9 sikur thatë "krahasuar me dokumentet e sekuestrimit të parë" -
10 a mund të na e shpjegoni çka keni parasysh?

11 Pë. Anëtarët e stafit të ZPS-së i krahasuan dokumentet e
12 sekuestruara me dokumentet e sekuestruara më parë dhe kjo u bë
13 në zyrë, në Prishtinë. Unë nuk mora pjesë në këtë dhe nuk di
14 më shumë hollësi.

15 Z. PACE: [Përkthim] Vetëm sa të konsultohem me kolegët e
16 mi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
18 rregull.

19 [Prokurorët e Specializuar këshillohen]

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, z. dëshmitar.

21 Prokuroria për momentin nuk ka pyetje të tjera për ju.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
23 i çaktivizuar].

24 Nuk e kisha mikrofonin e lëshuar. Mund të filloni me pyetjet,
25 z. Rees.

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 32

1 Z. REES: [Përkthim] Më lejoni vetëm një minutë, i nderuar
2 Gjykatës.

3 Pyetje të palës tjetër nga z. Rees:

4 Py. Z. Moberg, ti je një oficer i sigurisë operative, kështu?

5 Pë. Po.

6 Py. Në transkript, në procesverbal, thuhet se keni thënë që
7 jeni oficer i sigurisë së dëshmitarëve. Ishte një gabim?

8 Pë. Besoj që po. Titullin që kam është oficer i sigurisë
9 operative.

10 Py. Ju vetë nuk jeni i përfshirë në hetime?

11 Pë. Jo, përveçse jap mbështetje në ngjarje si kjo.

12 Py. Konferenca e parë e shtypit u mbajt me 7 shtator 2020. A
13 mësuat për atë konferencë atë ditë?

14 Pë. Mbërrita në Prishtinë, besoj, po atë ditë dhe u informova
15 diku pasdite se dokumentet ishin në OVL UÇK.

16 Py. Dhe kush jua dha këtë informacion?

17 Pë. Eprori im i drejtpërdrejtë.

18 Z. REES: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë private
19 shkurtimisht?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Të kalojmë
21 në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

10 Z. REES: [Përkthim]

11 Py. A ju kujtohet se në çfarë kohe ju informoi shefi juaj për
12 konferencën e shtypit?

13 Pë. Nuk më kujtohet koha e saktë, por ishte dikund pasdite.

14 Unë udhëtova për në Prishtinë dhe arrita atje rreth orës

15 15.00, kështu që duhet të ketë qenë rreth orës 16.00 apo diçka
16 e tillë.

17 Py. Ju faleminderit. Dhe të nesërmen në 12.24 minuta të ditës
18 ju ishit në zyrat e OVL UÇK-së, kështu?

19 Pë. Po.

20 Py. Po që se themi se u informuat për konferencën për shtyp
21 në orën 16:00, mbeten dikund rreth 20 orë deri në momentin kur
22 keni shkuar në zyrat e OVL UÇK-së. A është e saktë?

23 Pë. Po, e saktë.

24 Py. Dhe gjatë kësaj periudhe besoj që ju keni menduar se
25 dokumentet janë në shtabin e OVL UÇK-së?

1 Pë. Sipas informacionit që kisha, po.

2 Py. Dhe nga shefi juaj a kuptuat që ai ishte në dijeni të
3 konferencës për shtyp meqë ai ju informoi juve rreth orës
4 16:00 në datën 7 shtator?

5 Pë. A mund ta përsëritni pyetjen?

6 Py. A besoni që shefi juaj ka qenë i informuar për press
7 konferencën meqë ju ka informuar vetë në orën 16:00, pra a ka
8 qenë ai i informuar para kësaj ore?

9 Pë. Besoj që po meqë më informoi mua.

10 Py. Kur shkuat të nesërmen atje, shkuat bashkë me një oficer
11 tjetër të sigurisë operative, kështu?

12 Pë. Po.

13 Py. Dhe as ju vetë e as ky oficeri i dytë i sigurisë
14 operative nuk e flisni shqipen?

15 Pë. Saktë.

16 Py. D.m.th. keni pasur ndihmën dhe shërbimin e një përkthyesi
17 të EULEX-it? Është e saktë.

18 Pë. E saktë.

19 Py. Para se të shkonit në OVL UÇK, a kontaktuat dikënd prej
20 asaj zyre?

21 Pë. Cilës zyrë?

22 Py. Zyra OVL UÇK-së.

23 Pë. Po, nuk e di në qoftë se personi punon aty -- Në mbrëmjen
24 e datës 7, e thirrëm një numër telefoni që dikush e kishte
25 gjetur dhe që mendonte se ishte i zyrës së OVL UÇK-së dhe

- 1 telefonuam për të parë në qoftë se mund të kontaktonim z.
2 Gucati. Mendoj që personi që u përgjigj në atë telefonatë
3 ishte një punonjës i informacionit të teknologjisë.
4 Py. Z. Gucati nuk ka qenë i pranishëm kur ju mbërritët në
5 zyrat e OVL UÇK-së të nesërmen, mirëpo ju atëherë folët me
6 sekretarin e OVL UÇK-së. A është kështu?
7 Pë. Po.
8 Py. Dhe të pranishëm ishin edhe persona të tjerë, ndër të
9 cilët një zonjë, Taibe Miftari. Ju kujtohet kjo?
10 Pë. Disa njerëz hynin dhe dilnin nga zyra. Nuk më kujtohet
11 kryesisht.
12 Py. Znj. Miftari ishte në fakt personi i parë që takuat në
13 krye të shkallëve. Ju kujtohet?
14 Pë. Jo me hollësi. Jo.
15 Py. Ju kërkuat që ta takonit dikënd që ishte përgjegjës aty
16 atë ditë dhe ajo zonja ju mori dhe ju çoi te z. Klinaku. Ju
17 kujtohet kjo?
18 Pë. Po. Mendoj që ishte në kantinë kjo.
19 Py. Në kantinë -- në kafeteri a ishte ai me z. Pren?
20 Pë. Nuk më kujtohet se kush ishte me atë, mirëpo e di që
21 ishin edhe njerëz të tjerë rreth atij në tavolinë.
22 Py. Dhe kur shkuat në zyrë, aty me ju erdhi edhe z. Gashi. Ju
23 kujtohet kjo?
24 Pë. Nuk më kujtohen emrat.
25 Py. Dhe ju më pas morët një kafe bashkë me ta, kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. Komunikimi juaj me këta persona u bë përmes përkthyesit,
3 kështu?

4 Pë. Po.

5 Py. D.m.th. gjithçka që thatë ju për personat të cilëve iu
6 drejtuat, u tha përmes përkthimit të përkthyesit të EULEX-it,
7 kështu?

8 Pë. E saktë. Mendoj që një prej personave fliste pak
9 anglisht, mirëpo, përgjithësisht, të gjitha çështjet që
10 lidheshin me sekuestrimin u përkthyen përmes përkthyesit.

11 Py. Një prej çështjeve që ngriti z. Klinaku në atë takim në
12 lidhje me dokumentet që po i diskutonit ishte se ata donin që
13 policia e Kosovës të përfshihej në dorëzimin e dokumenteve. Ju
14 kujtohet kjo?

15 Pë. Nuk më kujtohet.

16 Py. A ju kujtohet se në deklaratën tuaj, në paragrafin 7,
17 thoni se është bërë një bisedë rreth asaj që OVL UÇK-ja t'ia
18 dorëzonte dokumentet Prokurorisë së Kosovës?

19 Pë. Po, më kujtohet.

20 Py. D.m.th., me fjalë të tjera, ata donin që autoritete të
21 Kosovës, qoftë policia apo Prokuroria, të ishin të pranishëm
22 gjatë dorëzimit të dokumenteve? A ju kujtohet tani kjo?

23 Pë. Z. Klinaku tha që dëshironin që dokumentet t'ia dorëzonin
24 Prokurorisë së Kosovës.

25 Py. D.m.th. atmosfera ishte mjaft e relaksuar. U bë një

1 diskutim në lidhje me dokumentet që do të dorëzoheshin dhe u
2 diskutua që të bëhej njëfarë pauze e shkurtër në mënyrë që
3 t'iu mundësohej autoriteteve kosovare të vinin dhe të ishin të
4 pranishëm. Ju kujtohet kjo?

5 Pë. Nuk më kujtohet.

6 Py. Kujtesa jua j është pak si më e qartë për ngjarjet e 8
7 shtatorit krahasuar me ato të 17 dhe 22 shtatorit. Është kjo e
8 saktë?

9 Pë. Po.

10 Py. Po në lidhje me 8 shtatorin, kujtesa jua j në lidhje me
11 ngjarjet atë ditë a është e qartë apo kufizohet vetëm me atë
12 që keni parë dhe keni shënuar në deklaratë?

13 Pë. Besoj që është mjaft e qartë sepse kam qenë i përfshirë
14 në shkallë të konsiderueshme në ato ngjarje.

15 Py. Kur thoni që nuk ju kujtohen diskutimet për të pritur
16 mbërritjen e autoriteteve kosovare, në mënyrë që edhe ata të
17 jenë të pranishëm gjatë dorëzimit, a jeni duke thënë se kjo
18 nuk është thënë apo që është thënë, po juve nuk ju kujtohet?

19 Pë. Nuk më kujtohet të jetë thënë kjo.

20 Py. Ju faleminderit. Unë po ju sugjeroj se përgjigjja jua j
21 ishte se autoriteti i ZPS-së kishte epërsi ndaj autoriteteve
22 të Kosovës?

23 Pë. Nuk më kujtohet kjo.

24 Py. Dhe se autoritetet kosovare mund të përfshiheshin vetëm
25 me autorizimin e ZPS-së? Unë vetëm po parafrazoj thjesht për

1 ta paraqitur këtë si një mesazh të përgjithshëm.

2 Pë. Nuk më kujtohet.

3 Py. A e pranoni këtë si diçka të mundshme që është thënë apo
4 nuk ju kujtohet?

5 Pë. Sikurse thatë edhe vetë, ishte një ngjarje mjaft e qetë.
6 Megjithatë, shumë njerëz kërkonin të flisnin në të njëjtën
7 kohë dhe sidomos në fillim, kështu që ishte pak kaotike
8 atmosfera.

9 Py. Për t'ju bërë të qartë atyre se ZPS-ja kishte epërsi mbi
10 autoritetet prokuroriale dhe policore të Kosovës, ju thatë se
11 ju mund të prisnit për një muaj në zyrat e prokurorëve të
12 Kosovës apo të policisë për të ardhur ata dhe se ata mund të
13 vinin vetëm me miratimin e ZPS-së.

14 Pë. Kjo nuk është thënë asnjëherë.

15 Py. Atë që ua thatë anëtarëve të OVL UÇK-së të pranishëm, ua
16 thatë nëpërmjet përkthyesit apo jo? Kështu që nuk mund të na
17 thoni asgjë në lidhje me saktësinë e përkthimit apo jo?

18 Pë. E saktë. Mirëpo, nuk kisha kurrfarë indikacioni që një
19 përkthim në atë moment ishte i pasaktë.

20 Py. Duhet ta keni dëgjuar vetë në shqip për ta ditur në qoftë
21 se ajo që është thënë në shqip ka qenë e saktë apo jo? Kështu?

22 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Është aspekt
23 argumentativ dhe dëshmitari tashmë është përgjigjur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pranohet
25 kundërshtimi.

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Rees

Faqe 39

1 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a është moment
2 një përshtatshëm për të bërë pushimin? E di që është pak më
3 herët, por --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në qoftë
5 se ju keni pushim apo ndërroni temën, atëherë do ta bëjmë
6 pushimin tani dhe do të vazhdojmë në orën 11.30 minuta. Seanca
7 mbyllet.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 --- Pauza fillon në orën 10.56

10 --- Seanca rifillon në orën 11.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
12 Sekretare ju lutem shoqërojeni sërish dëshmitarin në sallën e
13 gjyqit.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem
16 uluni zoti Moberg.

17 Zoti Rees do të vazhdojë me marrjen tuaj në pyetje.

18 Z. Rees, e keni ju ende radhën.

19 Z. REES: [Përkthim] Jam i kënaqur të them që pasi
20 reflektova, kam përshtypjen që do të jem edhe më shkurt se sa
21 e kisha parashikuar paraprakisht.

22 Py. Z. Moberg. Ju lutem a mund të na ndihmoni me këtë. A jeni
23 në dijeni nëse zoti Joseph --

24 Z. PACE: [Përkthim][Mikrofoni çaktivizuar].

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mendoj që

1 e kuptoj Mbrojtja se për çfarë po ndodhte.

2 Z. REES: [Përkthim] Jo, por jam mirënjohës në fakt që
3 ndërhyri zoti Pace.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Është mirë
5 që dikush e di se çfarë po ndodh.

6 Z. REES: [Përkthim]
7 Py. Atëherë investigimi, le të themi investigimi ose hetimi
8 që keni marrë, ku keni marrë pjesë juve, me datë 17 shtator
9 dhe 22 shtator, ju e dini për kë e kam fjalën, për kë hetues e
10 kam fjalën, po apo jo?

11 Pë. Po.

12 Py. Ky hetuesi ka marrë në telefon zyrat e OVL në orën 18.50
13 në datën 16 shtator dhe ka diskutuar me Z. Klinaku dhe i ka
14 thënë atij që të mblidhen dokumentet. Ndërkohë që zoti Klinaku
15 ka thënë që ishte vonë, kështu që të vinte të nesërmen.
16 Ndërkohë që keni shkuar të nesërmen në zyrat e OVL UÇK-së. A e
17 mbani mend këtë gjë?

18 Pë. E mbaj mend që kam qenë pjesë e grupit në mëngjes. Por
19 nuk e mbaj mend telefonatën.

20 Py. A jeni në dijeni të kësaj.

21 Pë. Mundet të kem qenë por nuk e mbaj mend këtë gjë.

22 Py. Pra, kemi dy telefonata në ditën e konferencën e parë për
23 shtyp. Ditën e konferencës së dytë për shtyp dhe në fakt në të
24 dyja rastet u vendos që dokumentet të liheshin në zotërimin e
25 OVL së UÇK-së dhe të shkohej në zyrat e OVL së UÇK-së ditën e

1 nesërme? A ka ndodhur kështu?

2 Pë. Siç e thashë edhe më përpara nuk kam qenë i përfshirë në
3 telefonatat, në thirrjet e bëra kështu që nuk mund të them
4 ndonjë gjë lidhur me këtë.

5 Py. Po ju e pranoni që kjo është kronologjia e ndjekur apo
6 jo?

7 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dëshmitari nuk
8 është e nevojshme që ta pranojë këtë. Mbrojtja mund ta bëjë
9 këtë argument më vonë në qoftë se është i nevojshëm ai.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund t'i
11 përgjigjeni kësaj pyetje me "po" ose "jo". Domethënë pra në
12 qoftë se e pranoni këtë kronologji, "po" apo "jo".

13 Pë. Duket e arsyeshme. Kështu që do të them "po".

14 Py. Faleminderit. Do ju sugjeroj gjithashtu që me datë 8 keni
15 diskutuar dhe keni sugjeruar që dokumentet në zotërim të OVL
16 së UÇK-së t'i linit për një muaj, ndërkohë që flitej ose
17 shqyrtohej edhe mundësia e përfshirjes së policisë së Kosovës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [mikrofoni
19 çaktivizuar].

20 Z. REES: [Përkthim] Është pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem
22 bëjeni si pyetje se nuk është e qartë.

23 Z. REES: [Përkthim] Pyetjen ia thashë zotit Moberg që kjo
24 ishte thënë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem

1 thuajeni edhe një herë në formë pyetjeje.

2 Pë. Nuk jam dakord me këtë formulim.

3 Py. Me 22 shtator --

4 Z. REES: [Përkthim] Atëherë së pari a mund të shikojmë
5 dokumentin me numrin e identifikimit SPOE00220914.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal është
7 dokumenti që merr numrin P54.

8 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [mikrofoni
10 çaktivizuar].

11 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

12 Py. Pra është dokumenti P54. A e keni parë më përpara këtë
13 dokument zoti Moberg apo jo?

14 Pë. Nuk e mbaj mend.

15 Py. Në qoftë se do të të pyesja se kush e ka shkruar këtë
16 dokument, kur e ka shkruar, ti nuk do të ishe në gjendje që
17 t'i përgjigjeshe?

18 Pë. Jo, nuk jam në gjendje t'i përgjigjem kësaj pyetjeje.

19 Py. Në rregull. Ju folët për skanimin e dokumenteve në
20 ambientet e ZPS-së në Prishtinë, apo jo?

21 Pë. Po.

22 Py. Kur flet për skanimin e dokumenteve, e ke fjalën që
23 dokumentet të skanohen, të transferohen apo të konvertohen në
24 dosje elektronike në mënyrë që këto dokumente të mund të
25 çoheshin në zyrën e ZPS-së këtu në Hagë?

1 Pë. E saktë, por të enkriptoheshin.

2 Py. Kur po flisnit për skanimin nuk e kishit fjalën për
3 dërgimin në sistemin ZyLAB, po e kishit fjalën për skanimin
4 dhe të dërgoheshin me email, mendoj në lidhje me dokumentet e
5 22 shtatorit që ishin dërguar në një email të veçantë. Nuk do
6 të të jap shumë detaje por është ky emaili që i është dërguar
7 Zëvendësprokurorit të Specializuar. A jeni në dijeni të kësaj?

8 Pë. Siç e thashë, nuk kam qenë i përfshirë në atë proces.

9 Py. Në rregull.

10 Pë. Pra nuk mund të them asgjë.

11 Py. Pra për derisa nuk keni asistuar, nuk keni qenë i
12 përfshirë nuk mund të thoni gjë rreth kësaj, apo jo?

13 Pë. E saktë.

14 Py. Mirë në rregull. Kalojmë në një temë tjetër. Në qoftë se
15 mund të na ndihmoni ju lutem na jepni përgjigjen në qoftë se
16 nuk na ndihmoni dot ju lutem na thoni "jo". Çfarë njohurie
17 keni ju lidhur me hetimin të kryer nga ZPS-ja lidhur me
18 procesin sesi përfunduan dokumentet tek OVL e UÇK-së.

19 Pë. Nuk kam asnjë përfshirje.

20 Py. Kur thua që nuk kam përfshirje, do të thuash që nuk ke
21 njohuri?

22 Pë. Po.

23 Py. Faleminderit zoti Moberg.

24 Z. REES: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera me një
25 rezervë, në qoftë se do të bëhen nxjerrjet e tjera të

1 informacionit që do të kenë ndikim, do të kërkonim ndoshta që
2 të thirrej sërish ky nëpunës i ZPS-së që të pyetet përsëri.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kuptoj
4 rezervën. Besoj që kemi qenë të qartë sa i takon rithirrjes së
5 dëshmitarëve. Pra në qoftë se do të shikohet e nevojshme prej
6 jush mund t'i thërrisni ata në të ardhmen.

7 Z. Cadman e keni fjalën ju në qoftë se doni që të bëni
8 pyetje.

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës. Si
10 dje, jam plotësisht dakord me pozicionin e dëshmuar nga kolegu
11 im i nderuar. Por kam një dy-tre pyetje të tjera për të bërë
12 për dëshmitarin.

13 Pyetje të palës tjetër nga z. Cadman:

14 Py. Z. Moberg, ju thatë që nuk keni qenë i përfshirë në
15 bisedat telefonike që ju shpjegoi z. Rees. Arsyeja për këtë
16 siç e thatë dhe siç e kuptova unë nga dëshmia juaj është fakti
17 që ju nuk flisni shqip, a nuk është kështu?

18 Pë. Po, kështu është.

19 Py. A mund të konfirmoni gjithashtu që hetuesi ose oficeri që
20 përmendi z. Rees dhe që ka marrë pjesë në datat e konferencës
21 së dytë për shtyp, domethënë e di që nuk e keni shumë të qartë
22 memorien lidhur me të, po a e mbani mend në qoftë se ky hetues
23 fliste shqip apo jo?

24 Pë. Po, kështu ishte.

25 Py. Edhe a është e saktë që gjatë kësaj kohe nuk ishit në

1 gjendje që të ndiqnit bisedën sepse bëhej në shqip dhe që
2 ndërveprimi i vetëm që keni pasur me zotin Haradinaj ka qenë
3 në suedisht. Kështu thatë apo jo?

4 Pë. Po, e saktë është kjo.

5 Py. Ju përmendët që është bërë një diskutim një bisedë e
6 shkurtër, megjithëse siç e thatë dhe ju ishte thjesht një
7 bisedë prezantuese me dikë që fliste anglisht. A e mbani mend
8 kush ishte ky person?

9 Pë. Nuk e mbaj mend emrin e këtij personi.

10 Py. Dua që të shikoni deklaratën e dhënë prej jush me datë 21
11 tetor 2021.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për numrin P, por
13 bëhet fjalë për dokumentin 083988.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

15 Py. Është dokumenti të cilin e shtjelluam edhe sot paradite.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Është
17 dokumenti P92, z. Cadman.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 Ju lutem, a mund të shikon faqen e fundit, paragrafin 13.

20 Py. Në paragrafin 13 thuhet që ju keni kërkuar, pra thoni, ju
21 keni kërkuar një faqe kryesore, si një ballinë për të cilën
22 nuk ishte në dijeni z. Klinaku. A keni thënë këtë gjë apo nuk
23 e keni thënë këtë gjë?

24 Pë. Po.

25 Py. Dhe në fund një faqe e tillë nuk u zbulua asnjëherë, nuk

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Cadman

Faqe 46

1 u identifikua asnjëherë, nuk është kështu?

2 Pë. Jo me sa di unë?

3 Py. Në fakt, diskutimi ishte që përmendja e materialeve të
4 tjera ishte bërë kur ky person, burri misterioz kishte lënë
5 dokumentet në OVL e UÇK-së. A nuk ishte ky pozicioni z.
6 Klinaku.

7 Pë. Më vjen keq por nuk e kuptova. E thua dot edhe njëherë
8 pyetjen?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A është
10 pyetje zoti Cadman?

11 Z. CADMAN: [Përkthim]

12 Py. Përgjigja e z. Klinaku ishte që materialet shtesë ishin
13 përmendur nga ky burri misterioz që kishte lënë materialet në
14 OVL UÇK-së, a mbani mend këtë gjë?

15 Pë. Po e mbaj mend të më ketë thënë këtë gjë zoti Klinaku.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Siç e tha edhe zoti Rees më
17 përpara, ne rezervojmë të drejtën të bëjmë pyetje në qoftë se
18 na del ndonjë çështje më vonë. Për momentin nuk kemi pyetje të
19 tjera për dëshmitarin.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ndonjë
21 pyetje tjetër për dëshmitarin?

22 Z. PACE: [Përkthim] Jo të nderuar Gjykatës, nuk kemi
23 pyetje të tjera, por thjesht dua t'i kërkoj Gjykatës në qoftë
24 se dëshmitari duhet të jetë i pranishëm kur të lexoj
25 përmbledhjen e P92?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Doni që të
2 bëni një përmbledhje të P92?

3 Z. PACE: [Përkthim] Vetëm sepse është pranuar në pajtim
4 me rregullin 154.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po kemi ne
6 ca pyetje si Trup Gjykses. Kështu që le të bëjmë pyetjet tona
7 një herë dhe pastaj mund ta lemë dëshmitarin të shkojë dhe ju
8 bëni komentet tuaja sa i takon dokumentit P92.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

10 Pyetje nga Trupi Gjykses:

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Zoti dëshmitar, kemi disa
12 pyetje sa i takon detyrave me ZPS-në.

13 Pyetje a parë është kjo: kur keni filluar të punoni me
14 ZPS-në?

15 Pë. Kam filluar të punoj me ZPS-në që prej kohës kur u
16 themelua organizata. Unë kam punuar me ZPS-në që prej fillimit
17 të saj dhe kam punuar më përpara edhe me TFHS-në.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të na thuash
19 mesatarisht se kur ka qenë kjo?

20 Pë. Unë jam bërë pjesë e TFHS-ë në vitin 2015 dhe pastaj në
21 2016 jam transferuar tek ZPS-ja.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në dëshminë tuaj ju thoni që
23 jeni oficer operativ i sigurisë, ndërkohë që sot në faqen 30
24 rreshti 22 i transkriptit dhe e them këtë për pjesëmarrësit e
25 tjerë në sallë që të na ndjekin, zoti Moberg ju thoni

1 "A nuk ishit ju i përfshirë në hetimet?"

2 Përgjigja juaj ishte:

3 "Jo, nuk kam qenë i përfshirë përveçse të ofroja
4 mbështetje për ngjarje të tilla si kjo."

5 A e mban mend këtë gjë?

6 Pë. Po, e mbaj mend.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A na ndihmon dot ju lutem që
8 të kuptojmë se çfarë roli ke ti si oficer sigurie me pak
9 fjalë?

10 Pë. Me terma të përgjithshme, me fjalë të përgjithshme, një
11 pjesë e mirë e kompetencave të mia ushtrohet në terren, pra
12 duke ofruar siguri për stafin e ZPS-së gjithashtu punojmë
13 ngushtë edhe me departamente të ndryshme si për shembull,
14 sigurimin e dëshmitarit, me sigurimin e partnerëve të tjerë.
15 Dhe siç e thashë, pjesa më e madhe e punës tonë realizohet në
16 terren.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe gjatë periudhës që ke
18 shërbyer me SFHT-në dhe me ZPS-në cilat janë ato ose cili
19 është stafi që ka qenë më tepër në bashkëpunim të ngushtë me
20 juve.

21 Pë. Kanë qenë kryesisht hetuesit, prokurorët, siguria e
22 dëshmitarëve.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Gjatë ushtrimit të detyrave
24 tuaja me SFHT-në dhe me ZPS-në a keni pasur ndonjëherë arsye
25 për të besuar që një anëtar aktual apo i mëparshëm i ZPS-së ka

1 qenë i përfshirë në ndonjë mënyrë në dhënien e informacionit
2 të pa autorizuar për OVL UÇK-së?

3 Pë. Jo i nderuar Gjykatës.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ka pasur ndonjë arsye për të
5 besuar se një person që ka vepruar nën instruksione ose
6 kontrollin e ZPS-së ka qenë i përfshirë në ndonjë mënyrë në
7 dhënien e informacionit të paautorizuar për OVL UÇK-së?

8 Pë. Jo.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera,
10 faleminderit, zoti dëshmitar.

11 Faleminderit zoti Kryetar i seancës.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit Gjykatësi
13 Smith.

14 Kam një pyetje që ka të bëjë me datën 8 shtator. A i ke
15 transportuar ti vetë materialet që janë sekuestruar nga OVL e
16 UÇK-së në zyrat e organizatës tuaj në Prishtinë? A ke qenë ti
17 vetë fizikisht i pranishëm gjatë transportit?

18 Pë. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ke qenë i pranishëm me
20 materialet deri në momentin kur janë skanuar dhe
21 dixhitalizuar?

22 Pë. Po. Deri në momentin kur materialet janë dorëzuar dikujt,
23 nuk e mbaj mend se kush ka qenë, por përgjigja është "po".

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit zoti Kryetar.

1 Mirëmëngjes zoti Moberg. Kam edhe unë disa pyetje për
2 juve. Pyetja e parë është kjo. Na thatë më herët sot në
3 mëngjes që zoti Haradinaj e dinte që ju ishit suedez. A thatë
4 kështu?

5 Pë. Po se jemi takuar dy herë. Domethënë në takimin e dytë
6 dhe në takimin e tretë e dinte. Domethënë herën e parë që jemi
7 takuar me zotin Haradinaj dhe i kam thënë që jam suedez dhe
8 dinte që nga hera e parë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e dytë e imja është
10 që në një prej notave tuaja ke thënë ose deklarata, më shumë
11 se sa nota, është deklarate me datë 3 nëntor 2021. Pra ti ke
12 thënë që të ka thënë përkthyesi që biseda telefonike e zotit
13 Klinaku e bërë përpara se sa t'ju jepej dokumentet ishte me
14 zotin Gucati. Domethënë zoti Klinaku ka marrë në tel zotin
15 Gucati. A mund të na thoni se si e ka marrë vesh përkthyesi që
16 zoti Klinaku po fliste me zotin Gucati në telefon.

17 Pë. Po. Ne ishim ulur në zyrën e zotit Gucati. Zoti Klinaku
18 ishte ulur në tryezë dhe e bëri telefonatën përpara nesh, në
19 sytë tanë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra e dëgjuat?

21 Pë. Po unë e dëgjova bisedën po nuk mund të konfirmoj se
22 çfarë u tha. Por besoj se më pas, pasi u larguam nga zyra
23 përkthyesi më tha këtë gjë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra a e dëgjuat ju zotin
25 Klinaku që të përmendte fjalën ose emrin Gucati?

Dëshmitari: Daniel Moberg (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 51

1 Pë. Jo.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ose a t'u tha nga
3 përkthyesi?

4 Pë. Nuk e mbaj mend.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A të tha përkthyesi ty që
6 zoti Klinaku mori në telefon zoti Gucati dhe foli me zoti
7 Gucati?

8 Pë. Po kështu ishte.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mbani dot mend ndonjë gjë
10 më tepër?

11 Pë. Për përkthyesin?

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, për përkthyesin.

13 Pë. Asgjë më tepër, përveç faktit që u bë një bisedë
14 telefonike ndërmjet zotit Gucati dhe dukej sikur ai u informua
15 për kopjet që dukej t'i dorëzoheshin ZPS-së.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Pyetja e fundit
17 ka të bëjë me notën tuaj të fundit me datën 21 tetor 2020 që
18 është dokumenti P92, ku ju keni shkruar në paragrafin 7 që FK,
19 mendoj që bëhet fjalë për zotin Klinaku apo jo?

20 Pë. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë FK-ja informon DM-
22 në, apo jo?

23 Pë. Po.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që "tre kopje i janë dhënë
25 medias, specifikisht KosovaPress-it, Gazetës inFokus dhe T7".

1 Pyetja ime është kjo: pse të ka thënë zoti Klinaku ty që
2 këto kopje i janë dhënë medias? A të ka dhënë arsye të tjera
3 ai ty për këtë gjë?

4 Pë. Jo, nuk i mbaj mend arsyet e tjera.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit nuk kam pyetje
6 të tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
8 rregull. Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera atëherë do të doja
9 që t'ju falënderoja që ishit me ne sot dhe që dhatë dëshmi
10 përpara Trupit Gjykses zoti Moberg.

11 DËSHMITARI: Faleminderit i nderuar Gjykatës.

12 [Dëshmitari largohet]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull
14 zoti Pace për parashtrimin tuaj.

15 Z. PACE: [Përkthim]

16 Një gjë e parë që do të bëj është që siç e thatë do të
17 lexoj përmbledhjen e dokumentit P92, ndërkohë që kam dhe dy
18 njoftime të tjera të shkurtra për dy çështje të tjera të
19 shkurtra për të ngritur.

20 Përmbledhja që do të lexoj lidhur me provën materiale P92
21 që është pranuar më herët sot përfshihet në parashtrimin e
22 protokolluar F00411, Shtojca 1.

23 Në P92, W04876 thotë që së bashku me një anëtar tjetër të
24 stafit të ZPS-së me një përkthyes dhe me një vëzhgues të
25 pavarur më 8 shtator 2020 ai ka marrë pjesë ka qenë fizikisht

1 në ambientet e OVL UÇK-së në Prishtinë. Dhe ai lexoi fragmente
2 nga vendimi i Gjykatësit të vetëm që mban datën 7 shtator 2020
3 që autorizonte sekuestrimin sipas rregullës 42 të Rregullave
4 të Procedurës dhe Provave për përfaqësuesin e OVL UÇK-së.

5 Dëshmitari W04876 deklaroi që ia ka dorëzuar një kopje të
6 vendimit Faton Klinakut i cili ia ka dorëzuar dokumentet
7 W04876 dhe të dy kanë nënshkruar dokumentin e dorëzimit.

8 W04876 deklaroi që Klinaku vërejti që dokumentet që ai ka
9 dorëzuar janë dokumente që ka dorëzuar personi i
10 paidentifikuar dhe që i ka lënë në ambientet e OVL UÇK-së një
11 ditë më përpara dhe që iu ishin dhënë gjithashtu organeve
12 mediatike.

13 W04876 thotë që ka regjistruar xhirimet e sistemit të
14 kamerave të zyrave të OVL UÇK-së.

15 W04876 thotë që më pas i ka vendosur këto dokumente në një
16 qese plastike të provave dhe thotë që ditën e nesërme ia ka
17 dhënë këto dokumente për t'u transportuar në zyrën e ZPS-së në
18 Hagë pasi qesja e këtyre materialeve ishte vulosur.

19 Kaq kisha për të thënë sa i takon kësaj çështjeje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
21 më tej z. Pace.

22 Z. PACE: [Përkthim] Z. Halling nuk është i pranishëm
23 gjatë kësaj seance nuk e di në qoftë se e thashë për
24 procesverbal këtë gjë më përpara apo jo.

25 Tjetra që dua të trajtoj është siç është parashikuar

1 lidhur me urdhrin për nxjerrjen e materialeve është ai që
2 gjendet në F413. Dua të bëj një kërkesë për pezullimin e
3 urdhrin që përmban paragrafi 95(b) i vendimit F413.

4 Për shkak të faktit se ne si Prokurori duam të bëjmë një
5 kërkesë për leje të për të apeluar lidhur me këtë urdhër
6 konkret. Zbatimi i urdhrin që fillon sot, bie ndesh me
7 kërkesën tonë për të bërë apel. Për këtë arsye kërkojmë që ju
8 ta pezulloni urdhrin dhe e kam fjalën për paragrafin 95(b).

9 Dhe për të sqaruar ZPS-ja ka ndërmend që të ndërmarrë
10 urdhrin në paragrafin 95(c) do ta trajtojë në një fazë të
11 mëvonshme.

12 Kaq kisha në qoftë se ju keni pyetje mund t'i bëni. Pra
13 në qoftë se leja për apel bëhet pas orës 16.00, me kënaqësi do
14 t'ia jepnim Mbrojtjes dhe Trupit Gjykses që mos ju vijë të
15 hënën për të përshpejtuar procesin.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Z. PACE: [Përkthim] Çështja tjetër që kam është që ne
19 pyetëm dëshmitar 4841 dhe 4842 ata do të jenë të diponueshëm.
20 Por duhet t'i lajmërojmë pak përpara/ E fundit gjë, ka të bëjë
21 me urdhrin e mëngjesit për pranimin që ka të bëjë me dëshmitar
22 4841 konkretisht për dokumentin P1104 MFI që e përmendët si
23 paketa 2.

24 ZPS-ja do të ofrojë një version të redaktuar në fund të
25 ditës së punës dhe në frymën e këtij urdhri duam të bëjmë

1 redaktimet e njëjta edhe faqeve korresponduese të asaj pakete
2 dhe të paketave të tjera. Sepse kur të japim një version të
3 redaktuar mendoj që ka rëndësi t'i bëjmë edhe te paketat e
4 tjera sepse është pak a shumë e njëjta përmbajtje. Por presim
5 të dëgjojmë urdhrin tuaj, duke pasur parasysh që t'i
6 përmbahemi fushëveprimit të urdhrin tuaj të mëngjesit. Kështu
7 që presim të na udhëzoni për këtë çështje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
9 tjetër z. Pace?

10 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Z. Rees.

14 Z. REES: [Përkthim] Në lidhje me kërkesën për pezullimin
15 e urdhrin për nxjerrje të materialeve, siç i kuptoj unë
16 rregullat apo rregulloren, çdo apel kundër atij urdhri do të
17 kërkojë certifikimin e apelit sipas, apo lejen e apelit sipas
18 rregullit 77. Rregulli 171 parashikon se nuk duhet të ketë
19 efekte pezulluese ndryshe -- përveçse në qoftë se urdhërohet
20 në vendimin lejimit.

21 Pra për atë që kërkohet pezullimi, efekti pezullues për
22 ndaj paraqitjes së apelit të një kërkesë për certifikim apo
23 lejim dhe vetë vendimi në fakt, është një kërkesë që nuk ka
24 bazë, nuk bazohet në rregulla.

25 Rregulli 171 është shumë e qartë. Duke iu nënshtruar

1 rregullës 58(4) që trajton apelin e ndërmjetëm kundër
2 paraburgimit. Pra neve këtë e lëmë mënjanë për momentin:

3 Pra kërkesa nuk bazohet në rregullore dhe është e
4 parakohshme për mendimin tonë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
6 Faleminderit z. Rees.

7 Z. Pace, siç e kuptoj unë ju keni kërkuar pezullimin por
8 nuk keni bërë ndonjë mocion për apel të ndërmjetëm.

9 Z. PACE: [Përkthim] Po. për të qenë të qartë unë kërkoj
10 pezullimin për të mirën e procedurës. Kjo kërkesë do të jetë
11 pjesë e parashtrimit të sotëm. Por duke qenë që afati është
12 sot mendova që të jepnim njoftim për synimin tonë që të mos
13 duket se nuk marrim parasysh urdhrin tuaj.

14 Ne e dimë gjithashtu se rregulli 77 lejon deri në shtatë
15 ditë që një palë të bëjë kërkesë për leje për apel. Ne e
16 kuptojmë se apeli i kësaj çështjeje kërkon edhe miratimin. Pra
17 duke pasur parasysh urdhrin për nxjerrjen sot dhe se është një
18 çështje që të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, neve
19 synojmë që ta bëjmë kërkesën sot që është pjesë e të drejtave
20 tona. Ky është qëndrimi ynë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne do ta
22 trajtojmë kur të shohim dokumentin që do ta dorëzoni. Kështu
23 që për shkak të këtyre çështjeve ju nuk po e lini mënjanë
24 çështje tuaj besoj.

25 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi ndërmend për momentin të

1 thërrasim dëshmitarë të tjerë. Një çështje që ishte esenciale
2 për çështjen tonë si Prokurori, është ajo që zgjidhet me
3 pranimin e dokumenteve në lidhje me 4841.

4 Neve do ta rinovojmë kërkesën tonë më vonë pasi të
5 paraqesim për pranim dokumentet e tjera nga paketat, nga tre
6 paketat por dokumentet e paredaktuara.

7 Sigurisht që ne mund të bëjmë kërkesa, në vartësi të
8 vendimeve tuaja përfshirë Paketat 1, 2, 3.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dhe të
10 gjitha këto materiale do të na i vini në dispozicion të hënën?

11 Z. PACE: [Përkthim] P104 që është Paketa 2 do t'ju jepet
12 sot. Materiali tjetër që po diskutojmë është ai që duhet
13 nxjerrë sipas vendimit 102(3).

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk flas
15 për këtë. Flas për kërkesën për certifikim, pezullim, të
16 gjitha këto do të na i vini në dispozicion të hënën?

17 Z. PACE: [Përkthim] Sot do t'jua vëmë në dispozicion.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

19 Z. Rees.

20 Z. REES: [Përkthim] Më lejoni të them se do ta miratoja
21 qëndrimin e z. Pace se çështja e Prokurorisë nuk duhet mbyllur
22 pa u zgjidhur të gjitha çështjet e nxjerrjes së materialit.

23 Së dyti, ajo që dua të them lidhur me rregullin 171 dhe
24 efektin pezulluzes, jo vetëm kërkesa është e parakohshme sepse
25 ajo duhet bërë bashkë me kërkesën për certifikim, por rregulli

1 171 nuk parashikon efekti pezullues në pritje të një vendimi
2 për një kërkesë për certifikim për apel.

3 Rregulli 171 thotë shprehimisht se në periudhën kur
4 kërkohet leja, apeli nuk duhet të ketë efekt pezullues
5 përveçse kur urdhërohet në vendimin për certifikim. Nuk është
6 se pret certifikimin. Kjo është ajo që doja të ngrirja.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Juve duket
8 se pritët minutën e fundit dhe jeni në një pozitë të vështirë.

9 Z. PACE: [Përkthim] Po, por vendimi që ne kërkojmë leje
10 për ta apeluar mban datën 3 nëntor.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E di por
12 keni shumë pak kohë për të vepruar.

13 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e kuptoj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju filluat
15 të thonit diçka.

16 Z. PACE: [Përkthim] Po. Se leximi i asaj që thotë
17 Mbrojtja lidhur me rregullin 171 nuk është logjike.

18 Sepse në qoftë se kërkoni efektin pezullues do të ishte
19 plotësisht e padobishme për çështjen në diskutim. Pra nuk
20 është leximi i rregullt i rregullit 171. E kemi të drejtë ta
21 bëjmë kërkesën dhe ju si Trup Gjykses të jepni vendim.

22 Theksoj përsëri se afati që dhatë ju është sot. Afati i
23 zakonshëm për të kërkuar lejen për apel është shtatë ditë. Por
24 ne veprojmë në interes të shpejtësisë së procedurave.

25 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Urdhri me
2 gojë është që afati i nxjerrjes zgjatet në rastin tuaj deri të
3 hënën me qëllim që të keni mundësi t'a trajtoni.

4 Atë që ngritët ju z. Rees i kuptojmë shumë mirë. Kjo do
5 të na japë mundësinë që të trajtojmë të gjithë çështjen
6 njëkohësisht.

7 Kam nja dy gjëra të tjera.

8 Besoj që e mbaruat z. Pace?

9 Z. PACE: [Përkthim] Sa për të sqaruar. Ju thatë që afati
10 shtyhet deri të hënën.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [nuk ka
12 përkthim].

13 Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk kemi asnjë kundërshtim
14 sigurisht në qoftë se leja për të bërë apelimin do të merret.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të
16 diskutojmë për të marrë një vendim deri të hënën, kështu që
17 nuk mund të them deri të martën, por vendimi varet nga vendimi
18 [e pakuptueshme].

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,
20 kam disa gjëra.

21 Ju kërkuat shtyrjen e afatit për paraqitjen e raportit
22 ekspert. E di që afati që dhamë ne në një urdhër me gojë, 26
23 tetor, ju jep një afat deri të martën, që është data 9. Është
24 e mjaftueshme kjo kohë?

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Po është. Unë fola me ekspertin në

1 pushim dhe në vartësi të transkriptit që duhet ta marri -- unë
2 kujtova se ishte afati sot, prandaj e ngrita.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
4 rregull. Donim ta verifikonim. Pra afati është 9 nëntor. ZPS-
5 ja mund ta paraqesë njoftimin e saj brenda 7 ditësh të
6 njoftimit të raportit.

7 Në qoftë se ju doni t'i përgjigjeni njoftimit të
8 Prokurorisë do të keni 5 ditë nga momenti që merrni njoftimin
9 e Prokurorisë.

10 Dhe këtu përfundon urdhri me gojë.

11 Por, meqë jeni në këmbë a mund të na konfirmoni nëse
12 klienti juaj dëshiron të bëjë ndonjë deklaratë të hënën?

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Mund ta konfirmoj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra doni
15 t'i bëni deklaratat. Nuk ka problem për ne.

16 Z. REES: [Përkthim] Për mua është diçka e logjikshme.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Edhe për
18 ju?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë do
21 t'ju japim kohë për këtë.

22 Në bazë të kërkesës tuaj për t'i shtyrë pyetjet tuaja të
23 dëshmitarit 4841 dhe 4842, Trupi Gjykes vendos sa më poshtë.

24 ZPS-ja kërkohet që të dalë me një raport për çështje të
25 mbetura të rregullit 102(3) deri në 12 nëntor. Mund të kemi

1 kërkesë dhe për certifikim që e dimë që do të na bëhet një
2 kërkesë e tij dhe kjo mund të na çojë në ndërmarrjen e hapave
3 të tjera.

4 Pra në qoftë se ju doni të kërkonit pyetje të tjera, do
5 t'ju dëgjojmë.

6 Kaq kishte.

7 Ndonjë gjë tjetër? Atëherë do të shihemi përsëri në orën
8 09.30 të hënën dhe shpresojmë që do të jemi në gjendje që do
9 të trajtojmë të gjitha gjërat që thamë tani. Tani e ndërpresim
10 dhe takohemi të hënën në orën 09.30. Faleminderit.

11 --- Seanca mbyllet në orën 12.07

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25